

VENDIM
Nr. 904, datë 21.12.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 787, DATË 22.9.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRBËRJEN E KOMISIONEVE EPRORE TË CAKTIMIT TË
AFTËSISË PËR PUNË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, 2 e 3, të nenit 39/2, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministrit të Financave dhe ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 787, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, numri 22, Dr. Afrim Dangëllia, mjek psikiatër, anëtar në Komisionin Epror Psikiatri-Okulistikë, në mbështetje të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 39/3, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, zëvendësohet me Dr. Anila Hashorva, mjeke psikiatre në qendrën spitalore universitare “Nënë Tereza”, anëtar në Komisionin Epror Psikiatri-Okulistikë pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, deri në përfundimin e afatit të anëtarit të zëvendësuar.

2. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi